




Informacion

Për Ty që je i ri në Suedi



Språk: Albanska
Förvaltning: Sociala Resursförvaltningen
Enhet: Invandrarservice

REGJISTRI CIVIL (FOLKBOKFÖRING)

Kur të vendosesh për të banuar në Suedi është e rëndësishme të të regjistrohesh në *regjistrin civil (folkbokföringen)*. Me këtë rast do të marrësh numrin personal. Shko te *Administrata tatimore (Skatteverket)* me pasaportë dhe dokument që tregon se ke të drejtë qëndrimi apo leje qëndrimi. Merr poashtu *certifikatën martesore (äktenskapsbevis)* ose *certifikatën e lindjes (födelsebevis)* për fëmijët eventual, nëse i ke këto dokumente.

Shumë të drejta dhe detyrime në Suedi varen nëse je i regjistruar në zyrën civile dhe ku je i regjistruar. Psh. ti duhet të jesh i regjistruar në Malmo për të pasur të drejtë të studiosh SFI (suedisht për të huaj) në Malmö.

Ti duhet të jesh i regjistruar në banesën ku je duke banuar. Lajmëroje Administratën Tatimore nëse shpërngulesh në adresë të re.

Administrata Tatimore

<i>Adresa:</i>	Kattsundsgatan 7
<i>Telefoni:</i>	0771 - 567 567
<i>Orari i punës:</i>	Të hënë, të martën, të mërkurën dhe të premten në orën 10.00-16.00 Të enjten në orën 10.00-18.00

Lexo më shumë: www.skatteverket.se/privat/folkbokforing/flytta/flyttatillsverige

LETËRNJOFTIM (LEGITIMATION)

Ti ke nevojë për letërnjoftim (legitimation) suedez për të vërtetuar se kush je. Kjo mund të nevojitet në shumë situata, p.sh në bankë dhe gjatë vizitës tek mjeku. Në letërnjoftimin suedez është numri yt personal suedez. Ka shumë raste kur është e rëndësishme të tregohet letërnjoftimi.

Si letërnjoftim mund të përdoret patenta suedeze e shoferit ose karta e identitetit (kartë-ID).

Që Administrata Tatimore të lëshoj një kartë- ID ti duhet:

- Të kesh paguar taksën para se të shkosh në Administratën Tatimore
- Të vizitosh një zyrë të Administratës Tatimore që prodhon kartë-ID
- Të mund të dëshmosh se kush je ti. P. sh. përmes kartës së lejës së qëndrimit
- Të jesh i regjistruar në zyrën civile në Suedi

Administrata Tatimore

<i>Adresa:</i>	Kattsundsgatan 7
<i>Telefoni:</i>	0771 - 567 567
<i>Orari i punës:</i>	Të hënë, të martën, të mërkurën dhe të premten në orën 10.00-16.00 Të enjten në orën 10.00-18.00
<i>Lexo më shumë:</i>	www.skatteverket.se/privat/idkort

ARKA E SIGURIMIT (FÖRSÄKRINGSKASSAN)

Nëse ke të drejtën për të marrë ndonjë ndihmë nga Arka e Sigurimit duhet të shkosh atje për tu regjistruar. Së pari duhet të kesh marrë numrin tënd personal. Merr një kopje të vendimit me shkrim për leje qëndrimin kur të regjistrohesh.

Shembuj të ndihmave ekonomike nga Arka e Sigurimit:

Ndihmë banese (bostadsbidrag)

Ndihmë banese është një ndihmë për ty që ke vështirësi ta paguash qiranë. Nëse nuk ke banesë mund të kërkojë ndihmë për banesë nëse jeton me fëmijët tuaj. Është me rëndësi të lajmërosh Arkën e Sigurimit nëse shpërngulesh, nëse shumohet familja, apo rriten të ardhurat personale ose ndërrohet qiraja. Nëse ke marrë më shumë se sa që duhet ndihmë për banesë atëherë teprica duhet kthyer.

Ndihmë për fëmijë (barnbidrag)

Nëse je i regjistruar në Arkën e Sigurimit mund të marrësh ndihmë për fëmijë nën 16 vjeç e që kanë leje qëndrimi. Ndihma për fëmijë merret automatikisht pas lajmërimit të fëmijës në Arkën e Sigurimit.

Mbështetje alimentacioni (underhållsstöd)

Nëse je i divorcuar dhe banon me fëmijët atëherë prindi tjetër duhet të paguaj alimentacion. Nëse prindi nuk ka kushte të paguaj atëherë paguan Arka e Sigurimit. Nëse prindi tjetër ka vdekur atëherë të ndihmon Autoriteti i Pensioneve

Pagë prindërore (föräldrарpenning)

Familjet me fëmijë të mitur mund të marrin një pagesë prindërore. Nëqoftëse ti je në shtëpi duke u kujdesur për fëmijën tënd mund të marrësh pagesë prindërore.

Arka e Sigurimit

Adresa: Kattsundsgatan 7

Telefoni: 0771 - 567 567

Orari i punës: Të hënë, të martën, të mërkurën dhe të premten në orën
10.00-16.00
Të enjten në orën 10.00-18.00

Lexo më shumë në: www.forsakringskassan.se

SFI – SUEDISHTE PËR TË HUAJ (SVENSKA FÖR INVANDRARE)

SFI – suedishtja për të huaj është një arsimim themelor në gjuhën suedeze për emigrant të rritur. Qëllimi është që ti të mësosh suedishten për nevojat e punës dhe jetës së përditshme.

Ti ke të drejtë të studiosh SFI nëse je i *regjistruar në librin e amzës* në komunën e Malmos dhe që nuk di të lexosh dhe të shkruash suedisht aq mirë. Nëse e di norvegjishten apo danezishten mirë nuk ke të drejtë në SFI.

Kontaktoje Shërbimin për emigrant (Invandrarservice) nëse do të lexosh SFI.

Më shumë njoftime rreth SFI-së gjendet në: www.malmo.se/sfi

ORIENTIM SHOQËROR (SAMHÄLLSORIENTERING)

Si i ri në Suedi mund të shkosh në një kurs me orientim shoqëror. Kursi përmban informacione rreth Suedisë për ty që je i ri këtu. Këtu do të mësosh rreth sistemit shëndetësor, tregut të punës, banimit, ligjeve dhe se si funksionon Suedia. Kontaktoje Shërbimin për emigrant (Invandrarservice) nëse je i interesuar të marrësh pjesë në orientimin shoqëror

Lexo më shumë këtu: www.malmo.se/Ny-i-Sverige

ZYRA E PUNËSIMIT (Arbetsförmedlingen)

Në zyrën e punësimit mund të njoftohesh për vende të lira pune. Si i papunë të jepet përkrahje dhe shërbime, ndihmë rreth orientimit profesional dhe këshilla se si të kërkosh punë apo praktikë.

Për më shumë njoftime shiko: www.arbetsformedlingen.se ose
Telefona në: 0771- 416 416

Refugjatët duhet të kontaktojnë **Zyra e punësimit Integrim (integration)** në Amiralsgatan 13.

Si i posardhur emigrant mund të kontaktosh atë zyrë që i përshtatet më së shumti punës që ke bërë më parë. Nëse nuk ke qenë i punësuar zgjidh cilën zyrë që të përshatet ty më së miri.

Zyra e punësimit Shërbime (Service), Kungsgatan 6

Punë: tregëti/shitje, hotel/restorant, shërbim klientësh.

Zyra e punësimit Teknikë /Teknik), Storgatan 5

Punë: ndërtimtari, prodhim energjie, profesione grafike, TI, mirëmbajtje ndërtesash, bagëti, bujqësi, kopshtë, artikuj ushqimor/industria e artikujve ushqimor, pastrim, sanim/pastrim, teknik dhëmbësh, transport/magazinë, uzinë/teknikë.

Zyra e punësimit Kujdesi dhe Administrata (Vård och Administration),

Södra Förstadsgatan 35

Punë: nëpunës banke apo sigurimi, jurist, zyrë dhe administrim mësues, administratë publike, përkujdesje fëmijësh dhe shëndetësi.

Zyra e punësimit

Faqja në internet: www.arbetsformedlingen.se

Telefoni: 0771 - 416 416

KREDI PËR PAJISJE SHTËPIAKE (HEMUTRUSTNINGSLÅN)

Kredia për pajisje shtëpiake janë të holla që ti i huazon për të blerë mobile dhe gjëra tjera për shtëpi. Kjo është për ty që je refugjat apo familjar të tij. Ti huazon nga CSN-ja por kontaktoje Shërbimin për emigrant (Invandrarservice) dhe ata të ndihmojnë të huazosh.

- Madhësia e kredisë varet nga anëtarët e familjes dhe nëse e ke banesën tuaj apo banon tek dikush
- Si familje konsiderohet, burri, gruaja, bashkëjetuesi që është refugjat dhe ka të drejtë për kredi, si dhe fëmijët që banojnë në shtëpi dhe nuk i kanë mbushur 21 vjeç.
- Bashkëshortët/bashkëjetuesit kanë përgjegjësi të përbashkët për t'a kthyer kredinë. Kjo vlenë edhe nëse divorcoheni.
- Për të aplikuar për kredi për pajisje shtëpiake duhet të rezervosh kohë në sportelin e Shërbimit për emigrant (Invandrarservice), telefoni 34 19 94.

Për më shumë informacione: www.csn.se/hemustrustningslan

LAJMËRIMI PËR NË PARASHKOLLË (ANMÄLAN TILL FÖRSKOLA)

Fëmijët mund të shkojnë në parashkollë nga mosha një vjeçare e deri sa të fillojnë shkollën. Lajmëroje fëmijun sëpaku katër muaj para datës për të cilën ke nevojë për vend në parashkollë.

Veuro kështu për të aplikuar për në parashkollat komunale:

Plotësoje formularin i cili gjendet në zyrën e qytetarëve
www.malmo.se

Ti mund të apikosh edhe në www.malmo.se/forskola

Ti do të lajmërohesh përmes një letre kur të ketë një vend të lirë. Për të marrë vendin ti duhet të përgjigjesh përmes letrës ku ti deklaroresh se e pranon vendin brenda një afati të caktuar. Nëse nuk përgjigjesh të humb vendi dhe lajmërimi shlyhet. Kur të marrësh vendin ti duhet të dërgosh lajmërimin e të ardhurave në Departamentin e Debitimit. Nëse nuk e bënë këtë atëherë do të paguash taksën më të lartë.

Mund të kërkosh vend edhe në parashkolla private. Lajmërimi bëhet në parashkollën përkatëse direkt. Informacione rreth këtyre gjendet në www.malmo.se/forskola

Parashkollat komunale punojnë ditëve të punës, e hëne – e premte 06.15 - 17.30. Nëse është e nevojshme mund të zgjatet orari i punës deri në 18.30.

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë në parashkollë të përgjithshme, 15 orë në javë nga vjesha e vitit kur fëmija mbushë tre vjet.

REGJISTRIMI NË SHKOLLË FILLORE (INSKRIVNING I GRUNDSKOLAN)

Fëmijë të posardhur nga mosha 6 deri në 16 vjet duhet të shkojnë në Njësine e Gjuhës Amtare (Modersmålsenheten) në shkollën Mosaikskolan për tu regjistruar në shkollë. Së paku një prind apo kujdestar juridik duhet t'a shoqëroj fëmijun. Shkolla fillora është e obligueshme nga mosha 7 deri në moshën 16 vjeçare.

Fëmija dhe prindi ose *kujdestari juridik (vårdnadshavare)* duhet të kenë letërnjoftim. Është e pranueshme karta e lejes së qëndrimit lëshuar nga Bordi i Migracionit.

Nëse ti punon ose studion ke të drejtë për vend kopshti të kohës së lirë për fëmijun tuaj. Kjo vlen që kur fëmija shkon në klasën parashkollore e deri në moshën 13 vjeçare. Kopshti i kohës së lirë hapet në mëngjes pra se të filloj shkolla dhe pasdite kur përfundon shkolla. Pyet në shkollën e fëmijës se si të aplikosh për vend në kopsht të kohës së lirë.

Mosaikskolan

<i>Adresa:</i>	Rönblomsgatan 6 A
<i>Telefoni:</i>	0729 – 814121
<i>Orari për telefonata:</i>	e hëne-premte 08:00-09:00
<i>Orari i punës Për regjistrim:</i>	e martë, e mërkurë, e enjte 09:00 -13:00

REGJISTRIMI NË INTRUDUKSIONIN GJUHËSOR (SPRÅKINTRODUKTION)

Nëse je i posardhur i moshës 16 deri 20 vjeç mund të marrësh pjesë në intruduksionin gjuhësor. Aty mund të mësosh suedisht, për të shkuar pastaj në shkollën e mesme, apo në ndonjë arsimim tjetër.

Për regjistrim kontakto:

Peggy Thornström

Värnhemsskolan

Kungsgatan 44

076-6076912

Orari për telefonata: E hëne-premte 10:00-11:00

peggy.thornstrom@malmo.se

BORDI PËR MIGRAICION (MIGRATIONSVERKET)

Bordi për migracion është institucioni i cili i shqyrton kërkesat nga personat që duan të banojnë në Suedi, të vijnë për vizitë, që kërkojnë shtetësi suedeze ose mbrojtje nga persekutimet.

Në Bordin për migracion mund të ndihmohet me:

- vazhdimin e lejes së qëndrimit
- regjistrimin e drejtës së qëndrimit
- shtetësinë suedeze
- dokument udhëtimi
- pasaportë për të huaj
- vazhdimin e lejes për vizitë

Bordi për Migracion

<i>Adresa:</i>	Agnesfridsvägen 111
<i>Telefoni:</i>	0771-235 235
<i>Orari për telefonata:</i>	E hëne-premte 08:00-16:00
<i>Orari i punës:</i>	E hëne-premte 09:00-15:00
Lexo më shumë:	www.migrationsverket.se

SHËNDETËSIA (SJUKVÅRD)

Të gjithë që banojnë dhe janë të regjistruar në Suedi kanë të drejtë në kujdes shëndetësor. Nëse ke nevojë për mjekim drejtohu në radhë të parë në ambulancën tuaj. Ti mund të zgjedhësh vet se cilës ambulancë do t'i takosh.

Nëse je i sëmurë dhe do të pyesësh për diçka, mund të telefonosh në informacionin e shëndetësisë. Aty mund të flasësh me një infermiere, e cila të jep këshilla, dhe të drejton për në ordinancë adekuate.

Me rastin e sëmundjeve serioze emergjente ose fatkeqësive mund të shkosh në Ordinancën Emergjente. Telefeno në 1177 para vizitës tuaj, për të ndihmuar se a ke nevojë të shkosh në emergjencë. Nëse rasti është urgjent dhe ke nevojë për ndihmë të shpejtë mund të telefonosh në 112.

Në www.1177.se mund të gjesh informacione rreth shëndetësisë në Skåne. Aty gjen njoftime se cilat ambulanca mund t'i zgjedhësh, informacione rreth sëmundjeve të ndryshme dhe të drejtave tuaja etj.

Nëse ke nevojë për përkthyes atëherë organet shëndetësore e rezervojnë atë. Ti ke të drejtë në përkthyes dhe është falas.

Të gjithë fëmijët deri në moshën gjashtë vjeçare duhet të kenë kontakt me ambulancën e fëmijëve. Aty bëhen kontrollimet dhe bëhet vaksinimi i fëmijëve. Aty mund të këshillohesh për gjithçka rreth zhvillimit të fëmijës suaj.

Femrat shtatzëne mund të kontrollojnë shëndetin e vet dhe të fëmijëve në ordinancën e maternitetit. Aty mund të marrësh këshilla edhe rreth shëndetit seksual. Ordinancat e maternitetit e kanë një numër të përbashkët të telefonit i cili quhet "Mamia direkt". Shiko më poshtë të dhënat kontaktuese.

Me rastin e vizitës tek mjeku duhet zakonisht të paguash një taksë. Mbledhi ato që paguan në një *kartë të shpenzimeve të larta (högstnadskort)*. Ti ke nevojë të paguash më së shumti 1100:- brenda një viti. Nëse nuk vjen në vizitë të rezervuar do të paguash taksë dyfishe. Këtë taksë nuk mund t'a llogarisësh në kartën e shpenzimeve të larta. Nëse e di se nuk mund të vish në vizitë të rezervuar atëherë termini duhet ç'lajmëruar 24 orë para vizitës.

Shëndetësia

Informacioni i shëndetësisë
Klinika e Emergjencës
Situatë emergjente
Mamia direkt
Lexo më shumë:

Numri i telefonit: 1177
Adresa: Ruth Lindskogs gata 5
Numri i telefonit: 112
Numri i telefonit: 040-33 33 00
www.1177.se

KUJDESI DENTAR (TANDVÅRD)

Ti zgjedh vet nëse do të shkosh tek një mjek privat i dhëmbëve apo të Shërbimi publik dentar (*Folktandvården*).

Të rriturit duhet të paguajnë vet një pjesë të madhe të shpenzimeve. Një pjesë mund të mbulohet nga *Arka e Sigurimit (Försäkringskassan)* nëse je i regjistruar aty.

Fëmijët dhe të rinjtë nën 20 vjeç i kanë falas shërbimet dentare. U ofrohen kontrollime të rregullta që nga mosha tre vjeçare. Nëse fëmija i juaj ka probleme urgjente ti mund të rezervosh vet një kohë tek një mjek i dhëmbëve.

Nëse ke probleme urgjente me dhëmbë, kontakto në radhë të parë mjekun tuaj të dhëmbëve tek i cili vizitohesh. Nëse ke nevojë për ndihmë vikendeve dhe mbrëmjeve mund të telefonosh në 1177 dhe të njoftohesh për mjekun e dhëmbëve kujdestar.

Për më shumë lexo këtu: www.1177.se/Skane/Tema/Tander/

BANIMI (BOSTAD)

Në Malmo ekziston një sistem i radhës që quhet Boplats Syd. Aty mund të presësh në radhë për një banesë. Ata i ndërmjetësojnë banesat sipas radhës. Sa më gjatë të kesh pritur aq mundësi më të madhe ke për të marrë një banesë.

Ti mund të lajmërohesh në faqen e internetit në Boplats syd ose shko në zyrën e tyre. Kushton 300 korona në vit të qëndrosh në radhë.

Ti mund të kërkosh banesë edhe duke kontaktuar direkt pronarët privat të ndërtesave. Ata zakonisht i kanë rregullat e veta për qiradhënie dhe sistem të vetin të radhës.

Boplats syd

Adresa: Lejonetpassagen, Stortorget 8

Koha për vizitë: E hëne – e enjte 09:00-12:00 och 13:00-15:00
E premte 09:00-12:00

Numri i telefonit: 040-34 24 50

Lexo më shumë: www.boplatssyd.se

MË SHUMË NJOFTIME (MER INFORMATION)

www.informationsverige.se

Informacion rreth shoqërisë për emigrant dhe refugjatë të rinjë. Informacioni është përkthyer në: gjuhën arabe, darishte, anglisht, persishte, somalishte dhe tigrinjishte. Ti mund të shkarkosh edhe librin Rreth Suedisë e cila është e përkthyer në disa gjuhë.

www.informationsverige.se/Svenska/Samhalle/Sidor/Boken-Om-Sverige-pa-flera-sprak.aspx

www.sweden.se

Fakte dhe artikuj rreth Suedisë në: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjollisht, rusisht, kinezisht dhe arabisht.

www.dinsakerhet.se

Informacion se si mund të parandalosh fatkeqësit dhe çka mund të bësh në situata krize. Informacioni gjendet në 66 gjuhë.

www.8sidor.se

Lajme në suedishte të lehtë

<http://sverigesradio.se/International>

Lajme në gjuhë të ndryshme

www.malmo.se

Informacion rreth komunës së Malmos

FJALOR (ORDLISTA)

Regjistri i zyrës civile

Regjistri i zyrës civile do të thotë se regjistrohet vendbanimi. Shumë të drejta dhe detyrime varen se **nëse** je i regjistruar në zyrën civile dhe **ku** je i regjistruar.

Shërbimi Publik Dentar

Shërbimi publik dentar quhen institucionet publike të kujdesit të dhëmbëve. Alternativë e shërbimit publik dentar është kujdesi privat denat që kryhet nga ndërmarrjet private.

Certifikata e lindjes

Një certifikatë e lindjes tregon se ku dhe kur je lindur dhe cilët janë prindërit e tuaj.

Arka e Sigurimit

Arka e Sigurimit është një autoritet që përgjigjet për sistemin e mirëqenies. Ata i paguajnë shumë forma të ndihmës ekonomike që ekzistojnë në Suedi si psh. për familje dhe të sëmurët.

Karta e shpenzimeve të larta

Karta e shpenzimeve të larta është që ti të mos kesh nevojë të paguash më shumë se 1100 korona për vizita te mjeku brenda një viti. Sa herë që vizitohesh nga mjeku dhe e paguan taksën ti e merr një vulë në kartën tuaj. Kur të arrish shumën 1100 korona atëherë shërbimet mjekësore i ke falas për një periudhë.

Autoriteti i pensioneve

Autoriteti i pensioneve është organ shtetror i cili e ka përgjegjësinë për pensionet publike, pra të hollave që i merr njëriu i cili e lë punën psh. për shkak të moshës.

Administrata Tatimore

Administrata Taimore është një autoritet që përkujdeset për tatimet që të gjithë qytetarët paguajnë në Suedi. ata kanë edhe detyra tjera, si psh. zyra e gjendjes civile dhe lëshimi i letërnjoftimeve suedeze.

Certifikatë martese

Është një letër që vërteton se je i martuar.

Kujdestar juridik i fëmijës

Kujdestar juridik i një fëmijë është ai ose ata persona që e kanë përgjegjësinë juridike ndaj një fëmije. Zakonisht janë prindërit ata që janë kujdestar juridik por mund të jenë edhe persona të tjerë nëse prindërit nuk mund të përkujdesen për fëmijun.